



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.10/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Afijete Sada - Glllogjani, Faton Ademi, Kymete Kicaj, Milena Đerić, Zyhdi Haziri, Burim Ademi, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Asmon Kabashi nga Berglen, Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 25.01.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet e palejuar** ankesa Anr.10/2021 e datës 23.01.2021, e parashtruar nga Asmon Kabashi, nga Berglen Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datën 23.01.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Asman Kabashi në të cilën theksohet se ka aplikuar duke i ndjekur rregullat e për aplikim për regjistrim të votuesve jashtë Kosove, më datë 21.01.2021 në ora 17:56, dhe se në ora 18:00 ka pranuar një njoftim me email, aplikimi ka përfunduar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

### **Apeli është e palejuar**

Paneli, pasi që konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-së me të cilën ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se në rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesi i apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- **a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;**
- **b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;**
- **c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;**
- **d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;**
- **e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe**
- **f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.**

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është e palejuar. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 10/2021 më datën 25.01.2021.



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.